




Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim


Nr-DATË/A:	07Nr.156 /350-18055 datë 10.06.2020
REFERENC-Ë:	07Nr.350/18055 datë 19.05.2020
PËR/TO:	"Frutex" shpk, me pronar Shaqir Palushi-Novakë
KOPJE/COPY:	Drejtorinë e Inspeksionit, Dosje të Drejtorisë
NGA/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
	DREJTOR: Sanie KUQI Zyrtare e lartë për ndërtimtari: Doruntina Bytyqi ing.dipl.ndërt.
LËNDA/SUBJECT:	Aktvendim mbi Leje Ndërtimore

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350/18055 datë 19.05.2020 nga "Frutex" shpk, me pronar Shaqir Palushi-Novakë Prizren, për Leje Ndërtimore për objektin me destimin Prodhimi dhe deponimi i pijeve, me etazhitet P+0, në parcelën kadastrale 02785-19 dhe 02785-18, Parcela ndërtimore P-064 dhe P-065, Tersia 10, me numër referues të certifikatës Nr.1889 datë 11.03.2020 pronë e P.Sh. KK Suharekë, FRUTEX SH.P.K (qirambajtje për 99 vjet), andaj pas shqyrtimit të kërkesës ky organ vendos, si në Aktvendimin e bashkangjitur kësaj shkrese.

- AKTVENDIM MBI LEJEN NDËRTIMORE



Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 10.06.2020

Numri i vërtimit i lejes:

07Nr.156 /350-18055

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr.04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L-031, Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Ndërtimin e Objekteve 01-Nr-16-423, datë 26.01.2011, Rregullore për tarifa nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale 01Nr-16-9367, datë 31.12.2014; neni 2, pika 2.1 dhe 2.2 si dhe sipas Planit Zhvillimor Urban 01Nr.5820 datë 05.03.2008, duke u mbështetur në Planin Rregullues Urban "Zona Industriale Shirokë" 01 Nr.10074 datë 21.04.2009 kërkesës dhe dokumenteve të paraqitura nga "Frutex" shpk, me pronar Shaqir Palushi, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim lëshon këtë :

AKTVENDIM
(MBI LEJE NDËRTIMORE)

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:

Emri:	Frutex" shpk, me pronar Shaqir Palushi	Nr. Personal	
Adresa:	Novakë - Prizren	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Aplikim për leje ndërtimore: 07Nr.350/18055 datë 19.05.2020

Emri I Projektit:	Prodhimi dhe deponimi i pijeve		
Emri I Projektuesit:	"Arkis" Sh.P.K me seli në Prishtinë		
Adresa:	Rr. Rexhep Krasniqi OB.2 H2		
Telefoni:		Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI - Objekti III në kuadër të dy parcelave

Adresa: Rr "Ukë Bytyqi", Shirokë			
Zona(t) Kadastrale: Suharekë	Nr. i parcelave kadastrale:	GPS Koordinatat e objektit:	
Sipas çertifikatës me Nr.1889 të datës 11.03.2020 Zona Kadastrale Suharekë	02785-19	X=7483797.879	Y= 4690020.70
	02785-18	X=7483802.023	Y= 4689966.857

Lloji i ndërtimit të propozuar:

Prodhimi dhe deponimi i pijeve

Kategoria e ndërtimeve të propozuara:

Kategoria II

Gabariti	Depo 36.50m' x 27.60m' Oborri ekonomik 18.00m' x 27.69m'	Katshmëria:	(P+0), sipërfaqe të përgjithshme Bruto 1007.4m ²
Vija rregullative	Nga mesi i Rrugës B-B 8.0m'	Vija ndërtimore	15m' nga vija rregullative

Përshkrimi

Me këtë vendim, poseduesit të lejës ndërtimore "Frutex" shpk, me pronar Shaqir Palushi nga Novaka Prizren, i lejohet ndërtimi i objektit me destinim Prodhimi dhe deponimi i pijeve me etazhitet P+0.

Lokacioni i objektit është në kuadër të Planin Rregullues Urban "Zona Industriale Shirokë" 01 Nr.10074 datë 21.04.2009, ku sipas gjendjes së planifikuar, në parcelat kadastrale 02785-19 dhe 02785-18, është me destinim Depo të ndryshme ushqimore.

Objekti ka karakter të përhershëm me katshmëri P+0. Ndërtimi i objektit të bëhet konform Kushteve Ndërtimore të lëshuara nga ky organ: 07Nr.85/350-13141 datë 06.03.2020.

Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.

Poseduesi i Lejës Ndërtimore është i obliguar që:

- Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin.
- Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejën Ndërtimore;
 - Informata mbi Projektuesin;
 - Informata mbi Kontraktuesin;
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit.
- Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit;
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
 - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevojat të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin e ndërtimit, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur;
 - Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte

Lokacioni

nënligjore. Këto inspekte nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore.

- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejës Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rastet kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, investitori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftojë organet komunale.
- Obligohet investitori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njëjtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

Arsyetim

Aplikuesi "Frutex" shpk, me pronar Shaqir Palushi nga Novaka, Prizren përmes kërkesës 07Nr.350/18055 datë 19.05.2020 ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtim të objektit Prodhimi dhe deponimi i pijeve, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Aktvendimi mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr.83/350-13141 datë 06.03.2020 (kopje)
- Dëshmi për pagesën e taksës sipas njoftimit 07Nr.143/350-18055, datë 03.06.2020, në shumë prej 4200€, e paguar në Bankën per Biznes SH.A në Suharekë, sipas faturës komunale nr.0000531 datë 04.06.2020.
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor – nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09Nr.100 datë 12.05.2020.
- Pëlqim sanitar – nga Inspektori i Sanitar 09Nr.101 datë 12.05.2020.
- Pëlqim për menagjimin e mbeturinave Nr.prot.46/20 datë 12.03.2020, lëshuar nga NPRM "ECO-REGJIONI"- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Pëlqim për kyqje në rrjetin publik të Ujësjellësit dhe Kanalizimit –Hidroregjioni Jugor Prizren Nr.34 datë 12.05.2020.
- Pëlqim për rregullim të dokumentacionit teknik, KEDS-SH.A, Nr.515 datë: 03.06.2020.
- Pëlqimin për rmbrojtjen nga zjarri-nga Drejtoria për Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjencë Nr.03/03-25 datë 08.05.2020.
- Lejen Mjedisore Komunale-nga Drejtoria për Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjencë 03Nr.153/181-17382 datë 21.05.2020.
- Tri kopje të projektit zbatues dhe kopje elektronike
- Elaboratin gjeomekanik

00000000

Prizren, 19.05.2020
Në emër të Komitetit të Inspeksionit të Sektorit të Ndërtimit dhe
Arkitekturës

Prizren, 19.05.2020

- Kopje e planit dhe çertifikata e pronësisë
- Kontratën e noterizuar mbi të drejtën e shfytëzimit të parcelës 01Nr.16/6758 datë 22.10.2012
- Matjet gjeodezike nga gjeodeti i licensuar Hekuran Demiridate 19.05.2020
- Vërtetimin e tatimit në Pronë
- Kopje e dokumentit identifikues

Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, konform Planin Rregullues Urban "Zona Industriale Shirokë" 01 Nr.10074 datë 21.04.2009, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejës Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.


Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MMPH në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim – Komuna Suharekë
Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.156/350-18055 datë 10.06.2020

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Inspektoratit të Komunës;
- Dosjes së DUP-së

DREJTORI:
 Sanie KUQI



REPUBLICA E KOSOVES
 KOMUNA E SUHAREKES